AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# LAJM I FUNDIT! Parandalohen ngjarje të rënda kriminale në Rrëshen, kapet një 28-vjeçar me dy mina në çantë

24/01/2024 10:28

Finalizohet nga Komisariati i Policisë Mirditë, operacioni policor i koduar "Safe City".

Sekuestrohen 2 mina me telekomandë, 1 kallashnikov dhe municion luftarak.

Vihet në pranga një 28-vjeçar që transportonte minat dhe mbante në banesë 1 armë zjarri kallashnikov dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Mirditë, në vijim të megaoperacionit kombëtar "Sundimi i ligjit" dhe në bazë të informacioneve të siguruara nga inteligjenca policore, se një shtetas po transportonte mina me telekomandë që do të shërbenin për të kryer krime kundër personit, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Safe City".

Në hyrje të qytetit të Rrëshenit, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar shtetasin e dyshuar i cili lëvizte me këmbë, në drejtim të qytetit, dhe kanë ndërhyrë menjëherë. Si rezultat u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit M. Gj., 28 vjeç, banues në Qafë Unazë, njësia administrative Rubik, Mirditë, rezident në Malin e Zi.

Shërbimet e Policisë, gjatë kontrollit në çantën e shpinës së 28-vjeçarit, gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale, 2 mina me telekomandë, me lëndë plasëse C4.

Në vijim të veprimeve procedurale, gjatë kontrollit të kryer në banesën e këtij shtetasi, është gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri kallashnikov dhe një sasi municioni luftarak.

Nga veprimet e para hetimore dyshohet se 2 minat me telekomandë, 28-vjeçari i ka siguruar në Malin e Zi, ku ishte i punësuar.

Në bashkëpunim me Prokurorinë, vijon puna për dokumentimin e plotë të rrethanave të rastit dhe për identifikimin e shtetasve të tjerë të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

**Top Channel**

## Aktualitet »

Vodhën në dhjetor disa pajisje në gjimnazin fshati Gruemirë, identifikohen dhe arrestohen dy persona

24/01 10:18

Goditet rrjeti i prostitucionit në Tiranë, shfrytëzoheshin tre vajza të mitura! Ishin larguar nga banesat e tyre

24/01 09:28

Kërkohet ndryshimi i masës "arrest në shtëpi", shqyrtohet në Apel ankimimi i ish-kryeministrit Berisha, mbërrijnë avokatët

24/01 09:03

"Gërdeci"/ Mbahet seanca gjyqësore ndaj ish-ministrit, Mediu paraqitet në GJKKO

24/01 08:55

Trafikonte armë zjarri në Tiranë, bie në pranga 31-vjeçari, sekuestrohen pistoletë, kallashnikov dhe municion luftarak

24/01 08:41

Kërkon ndryshimin e masës "arrest në shtëpi", shqyrtohet sot në Apel ankimimi i ish-kryeministrit Berisha

24/01 08:07

## Kryesore »

Reforma Zgjedhore, OSBE/ODIHR: Nxisim palët politike për konsultime të hapura gjithëpërfshirëse

24/01 10:16

Përjashtimi i dinarit serb, DASH thirrje Kosovës: Duhet më shumë kohë, konsultohuni me komunitetet e prekura

24/01 10:02

Video/ Rama: Shpallim vitin 2024, Vitin e Gjuhës Shqipe! Manastirliu: Prioritet, investimi në arsim

24/01 09:52

Goditet rrjeti i prostitucionit në Tiranë, shfrytëzoheshin tre vajza të mitura! Ishin larguar nga banesat e tyre

24/01 09:28

Kërkohet ndryshimi i masës "arrest në shtëpi", shqyrtohet në Apel ankimimi i ish-kryeministrit Berisha, mbërrijnë avokatët

24/01 09:03

"Gërdeci"/ Mbahet seanca gjyqësore ndaj ish-ministrit, Mediu paraqitet në GJKKO

24/01 08:55

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »

Top News/ Vodhi në gjimnazin në Malësi të Madhe, autori kishte thyer masën e 'arrestit në shtëpi'

Top Channel/ Kërkohet ndryshimi i masës "arrest në shtëpi", mbërrijnë avokatët e Berishës

Top News/ Dita Ndërkombëtare e Arsimit, 2024 shpallet Viti i Gjuhës Shqipe



Top News/ Një hap pranë rikandidimit për president,Trump fiton zgjedhjet republikane në New Hampsher

Saide humb ndjenjat, studio shokohet nga ngjarja – Ep. 86 Përputhen 23/01/2024

Alba provokon, i zë karrigen Vedatit dhe flet me çunat e tjerë – Për'puthen Prapaskena

Top Channel Films

## Kryesore

Reforma Zgjedhore, OSBE/ODIHR: Nxisim palët politike për konsultime të hapura gjithëpërfshirëse

10:16

Ndryshimet klimatike/ Mijëra pinguinë perandorë po ngordhin nga shpërbërja e akullit, sateliti gjurmon katër grupe të reja

08:02

Alfio Rrotani lë garën e Big Brother VIP 3, i eleminuari i parë nga shtëpia më e famshme në Shqipëri

23:42

Modelja ukrainase fituese e Miss Japonisë, rindez debatin e identitetit

09:38

Chelsea siguron finalen në mënyrën më të bukur, protagonist edhe Broja

08:19

## Më të lexuarat

Rënia e skelës në Tiranë/ Të plagosurit vjehrri dhe bashkëshortja e ish-futbollistit të njohur! Shkëmbi për Top Channel: Do ta padis kompaninë 'Arlis'

Jo një, por dy! Cilët janë banorët më të rinj në Big Brother VIP 3

U martua vetëm disa ditë më parë/ Kush është shqiptari që humbi jetën në aksidentin tragjik në Itali, moderatorja e njohur prek me fjalët

Sonte spektakli më i ndjekur në Shqipëri, Big Brother Vip 3! Ja ku mund ta ndiqni LIVE

E papritur në Për'puthen! Saidja bie pa ndjenja në skenë, çfarë ndodhi me konkurrenten

"Na martoi një hoxhë", çfarë tha para hetuesve 16-vjeçarja: I shprehëm dashurinë njëri-tjetrit, marrëdhënia ndodhi me konsensus

Fiks Fare/ "Polici i kokainës" kthehet në detyrë, denoncuesi: Më falsifikuan firmën sikur u tërhoqa nga ankimi!

Nominime të hapura/ Katër banorë shkojnë në televotim! Publiku voton se cilin do të shpëtojë

Qytetet më të mira në botë për vitin 2024 sipas Time Out, cili kryeson listën

A do të disiplinohen banorët? Vëllai i Madh merr vendimin për ata që thyen rregullat! Kazermë brenda BBV



© Top Channel 2001 - 2024 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.